



KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

RAPORT
MONITORIMI PËR PERIUDHËN
JANAR-MARS 2023

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE
KUNDËR KORRUPSIONIT 2015 – 2023

www.drejtesia.gov.al

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE

- *Përmbledhje ekzekutive mbi progresin e zbatimit të planit të veprimit për janar-mars 2023*
- *Realizimi i rekomandimeve të lëna për zbatim në raportin vjetor 2023*
- *Metodologjia e hartimit të raportit të monitorimit*
- *Matrica e riskut*
- *Konsultimi publik*

PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

- *Masa dhe aktivitete të implementuara me sukses në periudhën përkatëse*
- *Statusi i masave dhe aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (Qasjet)*
- *Statusi i aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (Qasjet)*
- *Statusi i masave që kanë realizuar qëllimet e politikave (Qasjet)*
- *Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur masat dhe aktivitetet*
- *Histori suksesi (përmes masave priritare)*

EKZEKUTIMI I BUXHETIT

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- *Rekomandime*
- *Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit*
- *Vlerësimi i riskut duke përdorur masat dhe aktivitetet*
- *Hapat e rradhës*

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
ADB	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
ASHSGJ	Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor
ATP	Agjencia e Trajtimit të Pronave
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
GTA	Grupi Tematik për Antikorrupsionin
ILDKPKI	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
IML	Instituti i Mjeksisë Ligjore
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKK	Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KSHB	Komiteti Shqiptar i Birësimit
KSHZ	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit
QBZ	Qendra e Botimeve Zyrtare
SNKK	Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit

SPAK
SHÇBA
SHKBB
VKM

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve
Vendim i Këshillit të Ministrave

DRAFT

HYRJE

Korrupsioni është një kërcënim për demokracinë, mirëqeverisjen, konkurrencën e ndershme, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe politik të një vendi. Ai pengon rëndë zhvillimin ekonomik, duke krijuar një sistem pabarazie, paragjykimi e nepotizmi, duke shkatërruar besimin e njerëzve tek shteti i tyre, prandaj lufta kundër korrupsionit është sot një nga sfidat parësore të çdo shteti me kulturë demokratike, vizion dhe integritet të lartë. Qeveria ka dhe do vazhdojë në mënyrë të pandalur të ketë një vullnet të palëkundur në luftën kundër korrupsionit, përmes aksioneve parandaluese, masave ndëshkuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere.

Përparësia e qeverisë në fushën e luftës kundër korrupsionit, përkon më së miri me kushtëzimet e vendosura nga Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE. Lufta kundër korrupsionit është një ndër pesë politikat të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi në procesin e integritet evropian të vendit. Po kështu, parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, etj.

Prej vitit 2015, Shqipëria ndjek dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. Me Vendimin nr. 516, datë 1.7.2020 të Këshillit të Ministrave afati i zbatimit të SNKK u zgjat deri në vitin 2023. Vizioni i SNKK-së 2015-2023 është: *“Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm”*. Qëllimet madhore politikës së Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit janë parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi/edukimi rreth korrupsionit. Këto qëllime politikash (qasje) janë afatgjata dhe shtrihen përgjatë kohës së zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit.

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023, përmban 18 objektiva specifike, të cilët janë:

Parandalim:

- A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion
- A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike
- A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike
- A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit
- A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave
- A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike

A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut

A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion

A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë

A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit

A.11 Adoptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore

Ndëshkim:

B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit

B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit

B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar

B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit.

Ndërgjegjësim:

C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit

C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit

C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Përmbledhje ekzekutive mbi progresin e zbatimit të planit të veprimit për janar-mars 2023

Plani i Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023, parashikon masa dhe aktivitete specifike që duhen të realizohen për përmbushjen e këtyre objektivave, sipas afateve të detajuara në të.

Ky raport monitorimi, *janar - mars 2023*, paraqet vetëm realizimin e masave dhe aktiviteteve (produkteve) të Planit të Veprimit. Raporti identifikon progresin dhe ecurinë e zbatimit të masave për këtë periudhë monitorimi, duke marrë në konsideratë dhe vlerësim realizimin e tyre, shkallën e performancës së aktiviteteve të institucioneve që raportojnë aktiviteteve dhe masa në proces zbatimi dhe uljen e numrit të masave të pazbatuara.

Raporti identifikon arritjen e rekomandimeve dhe hapat për zbatimin e tyre, referuar rekomandimeve të lëna në raportin vjetor të monitorimit 2022. Në këtë analizë ofrohet gjithashtu informacioni për të parë relevancën e përmbajtjes së këtij plani veprimi përkundrejt arritjes së indikatorëve të parashikuar në Pasaportën e Indikatorëve, të objektivëve specifikë dhe të qëllimit madhor, atë të arritjes së qëllimeve të politikave (qasjeve) të Strategjisë, parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim.

Ky raport krijon dhe vendos të gjithë infrastrukturën analitike që rekomandimet e lëna të trajtohen në raportet pasardhës.

Për këtë periudhë monitorimi, *janar - mars 2023*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 59 masa e 105 aktivitete, të shpërndara përkatësisht në 30 masa e 56 aktivitete për qasjen parandaluese (A), 21 masa e 31 aktivitete për qasjen ndëshkuese (B) dhe 8 masa e 18 aktivitete për qasjen ndërgjegjësuese (C).

Përmes zbatimit të Planit të Veprimit për periudhën *janar - mars 2023*, janë zbatuar plotësisht 33 masa, pjesërisht 17 masa dhe nuk janë zbatuar 9 masa si dhe janë zbatuar plotësisht 65 aktivitete, pjesërisht 12 aktivitete dhe të pazbatuara janë 28 aktivitete.

Në vijim paraqitet realizueshmëria e objektivëve të strategjisë sipas shkallës së realizimit të masave dhe aktiviteteve:

Objektivat		Shkalla e realizimit sipas masave
Parandalimi	A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë	86 në 110 për qind e masave të zbatuara

	A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	A.11 Adaptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore	0 në 30 për qind e masave të zbatuara
Ndëshkimi	B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndërshkrimin penal të korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar	0 deri në 30 për qind e masave të zbatuara
	B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit	31 deri në 50 për qind e masave të zbatuara
Ndërgjegjësimi	C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.	0 deri në 30 për qind e masave të zbatuara

Për këtë periudhë *janar - mars 2023*, janë shënuar arritje në qëllimet e politikës (qasjen) parandaluese (A), ndëshkuese (B) dhe ndërgjegjësuere (C) të zbatimit të strategjisë, më konkretisht përmendim:

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka monitoruar $\frac{1}{4}$ e autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë, duke monitoruar 100 nga 313 autoritete publike dhe 16 nga 61 njësi të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve është instaluar në 27 autoritete publike të reja për këtë periudhë raportuese, duke e çuar numrin total në 222 autoritete publike që kanë instaluar regjistrin elektronik.
2. Agjencia e Prokurimit Publik vijon punën, në realizimin e masave që parashikon Plani i Veprimit Antikorrupsion. APP ka hartuar dhe miratuar instrumentat e nevojshëm për monitorimin e zbatimit të kontratës si dhe ka vijuar me forcimin e kapaciteteve të stafit. Gjithashtu ka publikuar edhe një udhërrëfyes orientues për të gjitha autoritetet kontraktore lidhur me zbatimin e prokurimit publik të gjelbër.

3. AKSHI ofron një total prej 1227 shërbime elektronike në portalin unik qeveritar e-Albania. Për të gjitha këto shërbime është kryer një analizë e regjistrave elektronike ndërveprues si dhe janë përcaktuar format e aplikimit. Kryerja e zhvillimeve teknike për ekspozimin e të dhënave nga e-sistemet fundore të institucioneve është realizuar poashtu në harmoni me zhvillimet teknike për të konsumuar webservice-t përkatëse të e-sistemeve dhe është strukturuar informacioni për publikim.
4. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore ka realizuar monitorimin dhe gjurmimin e rasteve nëpërmjet përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Çështjes, i është përgjigjur telefonatave të ardhura pranë numrit të gjelbër, ka administruar ankesa, ka zhvilluar hetime dhe në përfundim të kësaj veprimtarie ka sugjeruar fillimin e hetimit disiplinor të punonjësve të trupës së Policisë së Shtetit sipas nivelit të shkeljeve.
5. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar programi vjetor të TVP për vitin 2023, i cili parashikon që të trajnohen 350 auditues të brendshëm. Është kryer gjithashtu miratimi i planit vjetor të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, përfshirë Vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë.
6. Ministria e Drejtësisë vijon të ketë rezultate të qëndrueshme në drejtim të integritetit, edhe gjatë kësaj periudhe raportuese. Në vijim të hartimit dhe miratimit të vlerësimit të riskut të integritetit, hartimin dhe miratimin e Planeve të Integritetit, Ministria e Drejtësisë ka miratuar raportin vjetor të monitorimit 2022 për planin e saj të integritetit.
7. Gjatë kësaj periudhe, Bashkia Roskovec ka miratuar Planin e Integritetit, duke e cuar në 22 numrin total të institucioneve të vetqeverisjes vendore, që kanë miratuar një Plan Integriteti.
8. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, ka proceduar me 23 raporte përfundimtare hetimi administrativ dhe pas analizës së detajuar, ka propozuar 60 masa për fillimin e ecurisë disiplinore, 14 masa për largim nga detyra dhe ka dhënë 80 rekomandime. Gjithashtu, janë konstatuar/dyshuar elementë të veprave penale për disa çështje, konkretisht janë përgatitur 5 kallëzime për ndjekje penale ku janë kallëzuar 16 persona.
9. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e saj të varësisë, kanë realizuar një numër të lartë inspektimesh gjatë kësaj periudhe raportuese dhe kanë referuar masas administrative për subjektet private të konstatuara në shkelje.
10. Policia e Shtetit vijon bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë. Gjatë kësaj periudhe janë shkëmbyer gjithësej 163 praktika, nga të cilat: 103 praktika me Interpolin, 38 praktika me Europolin dhe 22 praktika me Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
11. Prokuroria e Përgjithshme ka regjistruar 37 procedime me 26 të pandehur dhe ka dërguar për gjykim 46 procedime me 48 të pandehur, për grupveprat në fushën e korrupsionit, çka përbën një rritje prej 64,3 % të procedimeve dërguar për gjykim dhe një rritje prej 60% të të pandehurve të dërguar për gjykim, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjithashtu shënohet një rritje me 5.8 herë e numrit të të pandehurve të dënuar për këtë grup veprash penale. Prokurorët kanë luajtur një rol aktiv në kryerjen e hetimeve proaktive dhe/ose

me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në 11 procedime penale, ndaj 42 subjekteve për veprat penale të korrupsionit dhe që lidhen me detyrën.

12. Gjithashtu është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për rritjen e efikasitetit në parandalimin dhe mbrojtjen e monedhave nga falsifikimi, si dhe për goditjen e veprimtarisë kriminale në këtë fushë, mes Prokurorisë së Përgjithshme, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme, e cila përcakton mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet palëve për rritjen e efektivitetit, aftësisë dhe bashkëveprimit ndër-institucional kundër falsifikimit të monedhave, si dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në këtë fushë.
13. Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit ka vijuar edhe me organizimin e aktiviteteve edukuese dhe ndërgjegjësuese. Është zhvilluar kështu, fushata e parë publike për vitin 2023, duke promovuar rritjen e koordinatoreve antikorrupsion, si një mekanizëm i sigurtë i luftës ndaj korrupsionit në përballjen e qytetarit me administratën publike. Në rrjetet e komunikimit të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion, Facebook, Twitter dhe LinkedIn, janë shfaqur një seri me 15 video udhëzuese dhe ndërgjegjësuese për të nxitur qytetarët duke denoncuar praktikën dhe abuzimet në institucionet publike, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve antikorrupsion. Këto video informuese, synojnë të promovojnë mekanizmin e raportimit të rasteve të dyshuara të korrupsionit, pranë koordinatoreve kundër korrupsionit.
14. Gjithashtu janë kryer dhe shpërndarë e-buletini mujor i muajit janar, shkurt dhe mars 2023, me një përmbledhje të gjithë projekteve, aktiviteteve dhe fushatave publike që ka kryer Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Realizimi i rekomandimeve të lëna për zbatim në raportin vjetor 2022

Për këtë periudhë *janar - mars 2023*, ka një ecuri dhe përmirësim në kryerjen e masave dhe aktiviteteve me qëllim plotësimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e mëparshëm të monitorimit (raporti vjetor 2022).

Vihet re një trend rritës dhe konsolidimi i rezultateve të qasjes ndëshkuese të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore. Gjithashtu AMVV ka kryer një përparim të lehtë gjatë kësaj periudhe monitorimi, në drejtim të forcimit të mekanizmave të integritetit në Njësitë e Vetqeverisjes Vendore për hartimin dhe zbatimin e instrumenteve të parashikuara në Planin e Veprimit.

Vetëm për këtë periudhë raportuese, prokuroria e Përgjithshme ka shënuar një rritje me 5.8 herë të numrit të të pandehurve të dënuar për grup veprat penale të korrupsionit, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në dallim nga të dhënat e monitoruara në raportet e kaluara të monitorimit, prokurorët kanë luajtur një rol aktiv në kryerjen e hetimeve proaktive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në 11 procedime penale, ndaj 42 subjekteve për veprat penale të korrupsionit.

Objektivi A2 ka një shkallë realizueshmërie shumë të mirë si pjesë e punës vijuese të APP. Objektivi A3 poashtu vijon të ruajë një nivel të lartë, falë realizueshmërisë së arritur më herët gjatë 2022 në dixhitalizimin e shërbimeve publike. Objektivi A.1, A.5, A.6 dhe A.7 ruajnë një nivel të mirë realizueshmërie, duke marrë në konsideratë edhe vlerat e raportit vjetor të monitorimit, në analizën e masave dhe aktiviteteve konkrete.

Ministria e Drejtësisë ka udhëhequr progresin në objektivet A8 dhe A9 duke ofruar kështu një kuadër të plotë dhe shumë më cilësor, në kuptim të vlerësimit të riskut të integritetit dhe verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë dhe të garancisë së shtuar për zbatimin e instrumenteve të integritetit.

Policia e Shtetit vijon të ketë rezultate të njëtrajtshme në funksion të realizueshmërisë së objektivëve B.1 dhe B.4. Objektivi C1 shënon rritje të ndërgjegjësimit publik dhe kuadrit të vizibilitetit në luftën kundër korrupsionit me një sërë produktesh që kanë përmirësuar gjithashtu besimin publik ndaj Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion.

Nga ana tjetër, mbetet sfidë moszbatimi i disa prej masave dhe aktiviteteve në objektivat B.3 dhe C3 (dhe/ose për të cilat raportimi nuk është arritur të mblidhet i plotë).

Për këtë periudhë raportimi vijojnë të adresohen si sfidë kryesore në zbatimin e planit të veprimit, çështje si:

- Identifikimi i problematikave dhe hapave të rradhës në aktivitetet që rezultojnë në statusin “Zbatuar pjesërisht” ose “Të pazbatuara”.
- Forcimi i kapaciteteve institucionale sipas nevojave të evidentuara nga institucionet përgjegjëse.
- Raportimi i buxhetit të përdorur për çdo aktivitet të realizuar.
- Kostimi dhe buxhetimi i aktiviteteve që raportohen të realizuara, të cilat kanë një impakt të drejtpërdrejtë në llogaritjen totale të buxhetit të zbatimit të strategjisë për këtë periudhë monitorimi.
- Mundësimi i ngritjes dhe funksionimit të një institucioni si Zyra e Rikuperimit të Aseteve.
- Plotësimi i mungesave nga AMSHC në drejtim të nxitjes së projekteve sipas kategorive të përcaktuara në Planin e Veprimit si dhe të përcaktojë një buxhet për mbështetjen e Projekteve të antikorrupsionit nga OSHC-të.
- Një bashkëpunim ende jo eficient dhe mungesa e koordinimit mes organeve të drejtësisë dhe institucioneve të tjera, siç janë organet e kontrollit të brendshëm, institucionet financiare, dhe organizatat e shoqërisë civile.
- Fuqizimi i mëtejshëm i kapaciteteve të organeve që ushtrojnë ndjekjen penale për të zhvilluar hetimet dhe ndjekur procedurat penale në rastet e korrupsionit, duke sofistikuar metodat e veçanta.
- Forcimi i qasjes ndëshkuese, zbatimi efektiv i hetimeve dhe ndjekja e procedurave penale përmes ekspertizës të specializuar, kapaciteteve të mjaftueshme dhe burimeve të disponueshme.

- Krijimi i proceseve të hapura dhe transparente në hartimin e politikave dhe ligjeve me qëllim krijimin e legjislacionit të mirë dhe për të mbështetur dhe realizuar nevojat institucionale në marrëveshjet shumëpalëshe të bashkëpunimit, duke pasuruar edhe diversitetin e pikëpamjeve në hartimin e politikave.

1.1 Metodologjia e monitorimit

1.1.1 Koordinimi institucional për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.618, datë 20.10.2021 dhe Urdhrit të Kryeministrit Nr.128, datë 08.11.2021, është miratuar struktura dhe organika e Ministrisë së Drejtësisë dhe është ngritur Sektori i Planifikimit dhe Monitorimit Strategjik në Fushën Antikorrupsion, pranë Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e raporteve periodike të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015 - 2023.

Ministria e Drejtësisë kryen koordinimin dhe organizimin e takimeve me të gjitha institucionet kontribuese, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SNKK) për periudhën 1 janar deri më 31 mars 2023 është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe kontributore të planit të veprimit.

1.1.2 Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raporte tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët do të prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SNKK-së.

1.1.3 Manuali i Raportimit sipas sistemit IPSIS

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS. Sipas këtij dokumenti strategjik, secili institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të çdo objektiwi dhe mase, mbi buxhetin e caktuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në përgjithësi. Bashkërendimi për respektimin e manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS do të kryhet me Agjencinë SASPAC.

1.1.4 Përputhshmëria e raporteve të monitorimit dhe performancës me parimet e Mirëqeverisjes

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse në përputhje me parimet e mirëqeverisjes.

Parimet e Mirëqeverisjes përmbajnë një kornizë të vlerësimit të Raporteve të Monitorimit dhe të Performancës e cila mundëson analizën e rregullt të progresit të arritur në zbatimin e Parimeve dhe caktimin e standardeve që duhet të përmbush vendi.

Parimet janë të hartuara për vendet që duan të anëtarësohen në BE dhe që marrin ndihmë nga BE-ja përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA). Kushtet e *acquis*, si dhe direktivat dhe udhëzimet e tjera të BE-së, janë thelbi i Parimeve në fushat ku ekzistojnë *acquis*. Në fushat e tjera, parimet rrjedhin nga standardet dhe kërkesat ndërkombëtare, si dhe nga praktikatat e mira në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet e OECD-së. Si standard minimal për një administratë të mirë të orientuar drejt performancës, vendet duhet të sigurojnë respektimin e këtyre parimeve themelore. Bashkërendimi për vlerësimin e raportit të monitorimit¹ dhe të performancës lidhur me përmbushjen e këtyre parimeve do të kryhet me Njësinë e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.

1.1.5 Mekanizimi i Integruar i Politikave

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.157, datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e Mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, janë krijuar 8 Grupe Tematike, të cilat janë pjesë e Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik. Konkretisht, për Ministrinë e Drejtësisë është ngritur Grupi Tematik Antikorrupsion (GTA).²

GMIP do të sigurojë një strukturë të menaxhimit të nivelit të lartë, lidhur me:

- vendimmarrjen politike dhe menaxheriale të nivelit të lartë në planifikimin dhe monitorimin e reformave sektoriale, politikave dhe kuadrit strategjik;
- koordinimin e planifikimit, programimit dhe monitorimit për sektorët e përfshirë, nëpërmjet organizimit të dialogut të rregullt me partnerët për zhvillim;
- ofrimin e mbështetjes në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- dialogun qeveritar mbi politikatat me partnerët për zhvillim, qeverisjen vendore, shoqërinë civile dhe sektorin privat, zbatimin e masave brenda fushës dhe sektorëve përkatës dhe promovimin dhe mbështetjen e iniciativave të koordinuara.

1.1.6 Fazat për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Fazat që do të ndiqen për përgatitjen dhe konsolidimin e raportit dhe monitorimit të performancës, paraqiten si më poshtë:

Faza 1: dërgimi i kërkesës për kontribut në datën 4 prill 2023 për të gjitha institucionet raportuese dhe konsolidimi i paketës në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes;

¹ Para se raporti i monitorimit dhe performancës të aprovohet në strukturat vendimmarrëse

² Këtë rol e luan Komiteti Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

Faza 2: dërgimi i paketës së plotë për vlerësim më datë **...2023** pranë Njësisë e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri për vlerësim të raportit të performancës në përputhje me parimet e mirëqeverisjes.

Faza 3: konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella nga Njësia e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri;

Faza 4: organizimi i mbledhjes së GTA-së më datë **...2023** për konsultimin e paketës së konsoliduar, marrjen e komenteve nga aktorët, si dhe miratimi i tij;

Faza 5: reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së raportit të monitorimit dhe performancës;

Faza 6: publikimi i raportit 3 muajor në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë;

Faza 7: dërgimi i procedurave (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) të mbledhjes së GTA-së dhe paketa finale, së bashku me linkun për njohje Njësisë së Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.

Faza 8: dërgimi i procedurave (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) të mbledhjes së GTA-së dhe paketa finale, së bashku me linkun për njohje Agjencisë SASPAC.

1.1.7 Parimet e Mirëqeverisjes që do të merren në konsideratë për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Raporti i Monitorimit dhe Performancës do të zbatojë parimet e mirëqeverisjes që do të duhet të ndiqen në zbatimin e një sistemi të mirë dhe efektiv të M & R-së:

- **EFIKASITETI:** Agregimi i niveleve të dokumenteve. Ky parim duhet të lejojë shfrytëzimin e sinergjive mes raporteve të dokumenteve të ndryshme. Nëse dokumentet janë të lidhura ngushtë në aspektin e përmbajtjes, atëherë sistemi i M & R-së duhet ta marrë këtë parasysh për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të njëri-tjetrit dhe jo mbivendosjen e njëri-tjetrit. Elementet bazë të raporteve të M & R-së (p.sh. objektivat, aktivitetet, indikatorët) në dokumentin e nivelit më të ulët do të zhvillohen drejt përmbajtjes së M & R-së në dokumentet e nivelit në të lartë. Duhet të merren parasysh lidhjet. Ky parim duhet të përmirësojë frekuencën dhe përmbajtjen e raporteve të M & R-së.
- **LLOGARIDHËNIA:** Respektimi i përmbajtjes së dokumenteve të planifikimit. Raportet e monitorimit duhet të përqendrohen në elementet e dokumenteve të planifikimit për të siguruar llogaridhënie lidhur me reformat dhe ndërhyrjet e planifikuara.
- **RËNDËSIA:** Respektimi i nevojave të përdoruesve të monitorimit dhe performancës. Raportet e M & R-së duhet të jenë të përshtatura për nevojat e përdoruesit në aspektin e përmbajtjes, gjatësisë dhe frekuencës. Për më tepër, raportet duhet të japin llogari për arritjen e rezultateve në mënyrë të verifikueshme dhe në raport me treguesit SMART.

Komponentët kryesorë që Raportet e Monitorimit dhe Performancës do të vlerësohen për përputhshmërinë me Parimet e Mirëqeverisjes lidhen me komponentët e mëposhtëm:

Qasja analitike e strukturuar bazuar në evidenca dhe konsultim

- Informacioni i dhënë shpjegon kuadrin metodologjik në përputhje me procedurat dhe standartet e sistemit.
- Progresi ndaj secilit qëllim politik dhe objektivi specifik të strategjisë bazuar në tregues si dhe zbatimin e reformave kryesore në sektor është paraqitur qartë.
- Shkalla në të cilën palët kryesore të interesit janë përfshirë në procesin e hartimit të raportit dhe raporti i monitorimit është konsultuar me të gjithë grupet si dhe publikuar në webin respektiv të institucionit (evidencë kryesore është raporti i konsultimit publik për procesin si dhe evidentimi që komentet janë marrë në konsideratë).
- Shkalla e paraqitjes analitike të zhvillimeve të sektorit globalisht ose në rajon.
- Shkalla e paraqitjes analitike të zbatimit të strategjisë me efekte në axhendën e integritimit evropian.
- Shkalla e paraqitjes analitike lidhur me identifikimin e fushës e cila adresohet për përmirësim si dhe efektet në ekzekutimin përgjithshëm të buxhetit.

Progresi i arritur vs qëllimet e politikave, objektivat specifike dhe masat

- Shkalla në të cilën progresi shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur treguesit e performancës. Është vlerësuar analiza përmes grafikëve, dashboards, analizës së thelluar dhe vizualisht përmes tabelave). Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës.
- Shkalla në të cilën progresi adreson vlerësimin e sfidave, boshllëqeve dhe jo efikasitetit (identifikohet qartë në raportin e monitorimit se cilat fusha (bazuar në qëllimet e politikave / objektivat specifike) tregojnë performancën më të dobët/jo rezultative, vs performancën më të lartë të objektivave, duke përdorur treguesit e rezultateve, përmes grafikëve, dashboards, analizës së thelluar dhe vizualisht përmes tabelave.
- Konkuluzionet dhe rekomandimet janë të bazuara në përputhje me evidencat e raportit dhe japin masa konkrete për korrigjim/përmirësim për t'u adresuar në vendimmarrje.

Performanca e kategorizuar sipas standarteve

- Përcaktimi i nivelit të arritjes së objektivit të secilit tregues të performancës është identifikuar. Është kryer mbledhja e të dhënave të disponueshme. Është llogaritur norma e realizimit të treguesit: 1) vlera e synuar, 2) vlera bazë dhe 3) të dhënat për arritjen e synimit.
- Niveli i arritjes së objektivit është përcaktuar. Gjithashtu është llogaritur norma mesatare e zbatimit të të gjithë treguesve të performancës lidhur me çdo objektivi të veçantë. (është kryer hedhja e të dhënave të niveleve të realizimit të çdo treguesi të lidhur me performancën dhe pjesëtimin me numrin e treguesve të performancës)
- Niveli i përcaktimit të shkallës së realizimit të objektivit për një nga katër (4) intervalet e sistemit të performancës është kryer dhe analizuar. Gjithashtu Intervali është përcaktuar në

bazë të nivelit të tolerancës. (i.dobët, ii. Mjaftueshëm, iii. Mirë, iv. Shumë mirë, v.Tejkaluar)

Risqet

- Shkalla në të cilën identifikohen risqet në nivel qëllimi politike dhe objektiv specifik në zbatim të Ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Shkalla në të cilën analizohen risqet në nivel qëllimi politike dhe objektiv specifik.
- Vlerësimi i riskut është kryer në përputhje me kategorizimet i.ulët; ii. mesëm dhe iii.lartë.
- Vlerësimi i mundësisë së ndodhjes së riskut është kryer në përputhje me kategorizimet i.ulët; ii. mesëm dhe iii.lartë.

Analizat financiare

- Shkalla e analizës së kryer lidhur me (i) në buxhetin e përdorur në periudhën e monitorimit, (ii) hendekun e financimit dhe (iii) nevojat e ardhshme.
- Analiza e buxhetit të përdorur është analizuar e lidhur me programet buxhetore (identifikohen saktë numri total i programeve buxhetore) në tre (3) nivele: (i) qëllimi i politikave (ii) objektivi specifik (iii) masat/ produktet si dhe totali për strategjinë.
- Shkalla e analizës financiare është kryer ku janë identifikuar dhe shkaqet e mungesës së fondeve dhe se si ky hendek do të trajtohet në të ardhmen.

Plani i Veprimit

- Plani është zbërthyer në realizueshmërinë e masave/produkte/aktivitete.
- Janë identifikuar institucionet zbatuese dhe kodet referuese për programet buxhetore.
- Janë identifikuar qartë periudha e realizueshmërisë.
- Institucionet e tjera/bashkëpunuese janë identifikuar.
- Masat/produktet janë të përputhura me produktet e programeve buxhetore (identifikohen qartë programet buxhetore)

1.1.8 Procedura për analizimin e të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës

Analiza e të dhënave është bërë në përputhje me parimet e mirëqeverisjes dhe strukturës vlerësuese për arritjen e performancës në Kryeministri.

Së pari është analizuar zbatimi i masave duke dhënë një rezultat sasior dhe cilësor të realizimit të tyre përkundrejt kryerjes së aktiviteteve respektive të lidhura me to.

Së dyti, është analizuar arritja e vlerës së synuar për këtë periudhë e përcaktuar në treguesit e performancës, duke vlerësuar gjithashtu edhe shkallën e ndikimit të masave të realizuara në arritjen e vlerës së synuar.

Së treti është analizuar realizimi i objektivëve specifikë përmes përlllogaritjes së realizimit të treguesve të performancës dhe përqindjes së masave të lidhura me objektivin përkatës të realizuara.

Zbatueshmëria e masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit klasifikohet me vlerat si më poshtë:

E zbatuar: është raportuar statusi “E zbatuar” për ato masa/aktivitete të cilat janë përmbushur.

Pjesërisht e zbatuar/Në proces: është raportuar statusi “Në proces” për ato masa/aktivitete, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.

E pazbatuar: Të pazbatuara janë raportuar ato masa/aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa/aktivitete për të cilat nuk ka pasur progres.

Për përllogaritjen e realizimit të objektivëve specifike sipas arritjes së masave të planifikuara për zbatim në këtë periudhë, është përdorur formula si më poshtë ³:

$$NR = \frac{TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR}{2\ TP} \times 100\%$$

Përllogaritja e realizimit të objektivit përkundrejt zbatimit të masave është kryer në bazë të 4 intervaleve të sistemit të performancës si në tabelën dhe kodin e ngjyrave më poshtë:⁴

Kategoria	Niveli i Tolerancës	Pikët (110)
Dobët	Nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara	30
Mjaftueshëm	Nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara	20
Mirë	Nga 51 në 85 për qind e masave të realizuara	35
Shumë mirë	Nga 86 në 110 për qind e masave të realizuara	25
Tejkaluar	111 dhe më lart	N/A

Niveli tjetër i analizës është realizuar sipas qëllimeve të politikës. Bazuar në të dhënat e realizueshmërisë për secilin nivel analitik (masa, tregues performance, objektiv specifik) është vlerësuar secili nga katër qëllimet e politikave: 1. Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien; 2. Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane; 3. Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit; 4. Koordinimi, manaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucione e sektorit.

³ Formula e përllogaritjes është marrë nga guida metodologjike e hartimit të raporteve të monitorimit të dokumenteve strategjike IPSIS.

⁴ Vlerësim është realizuar në përputhje me Guidën Metodologjike “Struktura e raporteve të monitorimit për dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes”.

Matrica e Riskut

Në raportin e monitorimit vlerësohet identifikim i risqeve me qëllim identifikimin e hapave që do të duhen të ndiqen për t'u adresuar në kuadër të implementimit të objektivëve të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

Vlerësimi i riskut është kryer në përputhje me tabelën më poshtë⁵:

Mundësia	E lartë	3	6	9
	E mesme	2	5	8
	E ulët	1	4	7
	E ulët		E mesme	E lartë
	Ndikimi			

1.1.9 Konsultimi publik i raportit të monitorimit dhe performancës

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë e dërgoi në datën 09.05.2023 dokumentin për konsultim të parë pranë institucioneve raportuese, si dhe me datë **_._.2023** vijoi me konsultimin e draftit të dytë dhe publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtesia.gov.al, në menu prioritete/strategjia ndërsektoriale/strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kreu reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e një takimi të dedikuar datë **_ maj 2023**, në kuadër të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimi të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit.

Raporti i konsultimit publik të raportit të monitorimit publikohet gjithashtu në faqen e internetit të ministrisë, www.drejtesia.gov.al.

⁵ Analiza dhe vlerësimi i riskut është kryer referuar Guidës Metodologjike për hartimin e raporteve të monitorimit për Agjendën e Mirëqeverisjes.

PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 ka si synim arritjen e objektivave madhorë të kësaj strategjie nëpërmjet realizimit të masave konkrete antikorrupsion, me qëllim zhvillimin e një shoqërie në të cilën ekziston një sistem i përgjegjshëm dhe efikas kundër korrupsionit, i cili është në gjendje për të përfituar rezultate të prekshme dhe të tregojë tendencë drejt eliminimit maksimal të kërcënimeve të korrupsionit, si dhe vullnetit për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Për të monitoruar ecurinë e SNKK 2015-2023, është hartuar raporti periodik i rradhës, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2020-2023, i cili mbulon periudhën *1 janar deri më 31 mars 2023*.

Masa dhe aktivite të implementuara me sukses në periudhën përkatëse

Qëllimet e politikave (qasjet) dhe objektivat specifikë bëhen të realizueshëm nëpërmjet masave dhe aktiviteteve të parashikuara (produkte), të parashikuara për zbatim, nga institucionet përgjegjëse edhe bashkëpunëtore të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit.

SNKK ka **tre qëllime kryesore politikash** (qasje) përmes të cilave synon të përmbushë vizionin e saj dhe 18 objektiva specifikë.

Duke aplikuar të njëjtën formulë⁶ të vlerësimit të shkallës së realizimit të objektivave – duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të qëllimeve të politikës dhe pjesuar me numrin e tyre – realizueshmëria e qëllimit strategjik ndërinstitutional kundër korrupsionit është 62.48%.

Qasja Parandaluese (A)	82.42%
Qasja Ndëshkuese (B)	50.87%
Qasja Ndërgjegjësuere (C)	54.16%

Megjithëse në këtë raport monitorimi vërehen arritje të rëndësishme për disa institucione, konstatohet gjithsesi një trend rënës në realizueshmërinë e të tre Qëllimeve të Politikës I, II e III (Qasja Parandaluese A-B-C) përkundrejt monitorimit të kryer në periudhën paraardhëse si dhe të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Krahasuar me periudhën *janar - dhjetor 2022*, që i përket periudhës së fundit të procesit të monitorimit, vihet re një trend rënës kryesisht në zbatimin e atyre masave dhe aktiviteteve të parashikuara për objektivë në të tre qëllimet e politikave (qasje) të SNKK, parandaluese – ndëshkuese – ndërgjegjësuere. Kështu qasja Parandaluese (A) shfaq një trend zbritës me 7.72%, Qasja Ndëshkuese (B) shfaq një trend zbritës me 24.13% dhe Qasja Ndërgjegjësuere (C) shfaq një trend zbritës me 2.74%. Për çdo rast duhet marrë në konsideratë që vlerësimi i të tre qasjeve në

⁶ Shiko footnote 3.

këtë periudhë monitorimi është mbështetur vetëm tek masat dhe aktivitetet për zbatimin, dhe jo tek shkalla e arritjes së treguesit.

Gjithashtu vërehet se dy nga tre qasjet paraqesin një trend pozitiv edhe kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar *janar - mars 2022*. Krahasuar me monitorimin e kryer në këtë raport, Qasja Parandaluese (A) shfaq një trend rritës me 24.09%, Qasja Ndëshkuese (B) shfaq një trend rritës me 4.27% dhe Qasja Ndërgjegjësuese (C) shfaq një trend zbritës me 1.09%.

Konkretisht sipas 18 objektivave specifikë, niveli i realizueshmërisë për këtë periudhë monitorimi sipas masave dhe aktiviteteve për zbatim për periudhën e monitorimit, është si më poshtë:

Qasja A	Realizueshmëria
A.1	66.66%
A.2	100%
A.3	100%
A.4	62.5%
A.5	100%
A.6	100%
A.7	90%
A.8	62.5%
A.9	100%
A.10	100%
A.11	25%

Qasja B	Realizueshmëria
B.1	71%
B.2	70%
B.3	25%
B.4	37.5%


Qasja C	Realizueshmëria
C.1	87.5%
C.2	75%
C.3	0%

Plani i Veprimit 2020 – 2023, për vitin 2023 parashikon zbatimin e 120 aktivitete e 73 masa, të shpërndara përkatësisht në 64 aktivitete e 37 masa për Qëllimin e Politikës I (qasjen parandaluese A), 32 aktivitete e 22 masa për Qëllimin e Politikës II (qasjen ndëshkuese B) dhe 24 aktivitete e 14 masa për Qëllimin e Politikës III (qasjen ndërgjegjësuese C).

Për këtë periudhë monitorimi, *janar - mars 2023*, rezulton se janë parashikuar për zbatim 105 aktivitete dhe 59 masa, nga të cilat: 101 aktivitete e 50 masa janë vijuese/në vazhdim nga periudha e vitit të mëparshëm (2020), 6 aktivitete dhe 4 masa janë të reja/që kanë filluar zbatimin në këtë tre-mujor të parë të vitit 2023.

		Aktivitete dhe Masa, janar - mars 2023
--	--	---

Qëllimet e Politikës (Qasja)	Aktivitetet dhe Masat	Aktivitete dhe Masa të parashikuara për vitin 2023	Aktivitete dhe Masa të parashikuara për 3M1 2023	Aktivitete dhe Masa në vijim ⁷	Aktivitete dhe Masa të reja ⁸
Parandaluese	Masa	38	30	29	1
	Aktivitete	65	56	55	1
Ndëshkuese	Masa	23	21	19	2
	Aktivitete	32	31	29	2
Ndërgjegjësuere	Masa	12	8	8	0
	Aktivitete	23	18	17	1
Total	Masa	73	59	56	3
	Aktivitete	120	105	101	4



Statusi i masave dhe aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (qasjet):

Progresi total i arritur në kuadër të përmbushjes së tre qëllimeve të politikës (qasjeve) të strategjisë lidhur me statusin e zbatimit të aktiviteteve dhe masave është si më poshtë:

- 33 masa e 65 aktivitete të zbatuara;

⁷ Aktivitete dhe masa që e kanë nisur zbatimin në periudhat e mëparshme të vitit 2022 dhe vazhdojnë zbatimin e tyre dhe në këtë tre-mujor të 2022.

⁸ Aktivitete dhe masa që e nisnin zbatimin e tyre në këtë tre-mujor të 2022.

- 17 masa e 12 aktivitete ende në proces zbatimi;
- 9 masa e 28 aktivitete të pazbatuara (përfshirë edhe masat e paraportuara të monitorimit).

Përsa më sipër, nga **33 masa e 65 aktivitete të zbatuara** për tremujorin e parë të vitit 2023, konkretisht 18 masa/42 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 11 masa/15 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 4 masa/8 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuese (C).


Nga **17 masa e 12 aktivitete të cilat janë ende në proces zbatimi** për tremujorin e parë të vitit 2023, konkretisht 10 masa/6 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 5 masa/4 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 2 masa/2 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuese (C).

Nga **9 masa e 28 aktivitete të pazbatuara** për tremujorin e parë të vitit 2023, konkretisht 2 masa/ 8 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 5 masa/ 12 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 2 masa/ 8 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuese (C).

Statusi i aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (qasjet):

Nga totali prej 105 aktiviteteve të parashikuara për zbatim në *janar - mars 2023*, 56 prej tyre i përkasin Qasjes A, 31 aktivitete i përkasin Qasjes B, si dhe 18 aktivitete Qasjes C.

Statusi i aktiviteteve në Planin e Veprimit 2020 - 2023, për periudhën janar-mars 2023				
Progresi i aktiviteteve	Qasja A (Parandaluese)	Qasja B (Ndëshkuese)	Qasja C (Ndërgjegjësuese)	Totali i Qasjeve
Zbatuar	42	15	8	65
Në proces	6	4	2	12
Pazbatuar	8	12	8	28
Totali	56	31	18	105




Rezultoni se nga 105 aktivitete të parashikuara për periudhën *janar - mars 2023*, aktivitete në vijim dhe të reja, statusi i tyre për të 3 qasjet është raportuar si më poshtë:

- 65 aktivitete të zbatuara;
- 12 aktivitete janë ende në proces zbatimi;
- 28 aktivitete të pazbatuara (paraportuara) nga institucioni përgjegjës (nga ku mund të përmendim A.4.2.1; A.4.3.1; A.4.4.3; A.7.3.2; A.7.3.3; A.7.3.4; A.8.7.1; A.11.3.1; B.1.2.1; B.1.2.2; B.2.3.1; B.2.3.2; B.2.3.3; B.2.3.4; B.2.3.5; B.2.4.2; B.3.4.1; B.4.1.2; B.4.3.1; B.4.4.1; C.2.1.1; C.2.2.1; C.3.1.1; C.3.1.2; C.3.1.3; C.3.1.4; C.3.1.5 dhe C.3.1.6).

Statusi i masave që kanë realizuar qëllimet e politikave (qasjet):

Nga totali prej 57 masash të parashikuara për zbatim në *janar - mars 2023*, 30 prej tyre i përkasin Qasjes A, 19 masa i përkasin Qasjes B, si dhe 8 masa Qasjes C.

Statusi i masave në Planin e Veprimit 2020 - 2023 për periudhën janar-mars 2023				
Progresi i masave	Qasja A (Parandaluese)	Qasja B (Ndëshkuese)	Qasja C (Ndërgjegjësuese)	Totali i Qasjeve
Zbatuar	18	11	4	33
Në proces	10	5	2	17
Pazbatuar	2	5	2	9
Totali	30	21	8	59



Rezulton se nga 59 masa të parashikuara për periudhën *janar - mars 2023*, masa në vijim dhe të reja, statusi i tyre për të 3 qasjet është raportuar si më poshtë:

- 33 masa të zbatuara;
- 17 masa janë ende në proces zbatimi;
- 9 masa të pazbatuara (paraportuara) nga institucioni përgjegjës (nga ku mund të përmendim A.8.7; A.11.3; B.1.2; B.2.3; B.3.4; B.4.3; B.4.4; C.2.1 dhe C.3.1).

Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur masat dhe aktivitetet:

Mbështetur në informacionin mbi raportimin dhe vlerësimin e aktiviteteve dhe masave të zbatuara, realizimi i objektivëve për *janar - mars 2023*, është si më poshtë.

Dobët - 3 objektiva (objektivi A.11; B.3 dhe C.3)

Mjaftueshëm - 1 objektiv (objektivi B.4)

Mirë - 6 objektiva (objektivi A.1; A.4; A.8; B.1; B.2 dhe C.2)

Shumë mirë - 8 objektiva (objektivi: A.2; A.3; A.5; A.6; A.7; A.9; A.10 dhe C.1)

Tejkaluar – N/A objektiva.

Histori suksesi (përmes masave prioritare)

Ecuria e arritur në kuadër të përmbushjes së aktiviteteve dhe masave të parashikuara, për periudhën e monitorimit, *janar - mars 2023*, në zbatim të Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015- 2023, është si më poshtë vijon:

- Agjencia e Prokurimit Publik ka publikuar një udhërrëfyes orientues për të gjitha Autoritetet Kontraktore në lidhje me zbatimin e prokurimit publik të gjelbër në Shqipëri dhe ka miratuar një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave, “Për formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik”.
- AKSHI ka siguruar një gamë të gjerë shërbimesh elektronike në portalin qeveritar e-Albania, duke përmirësuar qasjen e qytetarëve ndaj shërbimeve shtetërore. Përmirësimi i infrastrukturës teknike dhe harmonizimi i të dhënave për publikim janë hapa të rëndësishëm drejt modernizimit të administratës shtetërore.
- KQZ ka kryer seanca trajnimi me financierët e partive politike lidhur me formatin e standardizuar për raportimin vjetor, përdorimin e Platformës Elektronike për raportimin financiar si dhe ka zhvilluar tryeza pune me ekspertë të fushës për të forcuar kapacitetet e stafit teknik.
- Agjencia e Mbikqyrjes Policore ka administruar 800 telefonata pranë numrit të gjelbër dhe 233 ankesa pranë sistemit të Menaxhimit të Çështjeve/Moduli i Ankesave; ka kryer një punë proaktive në drejtim të hetimeve pranë strukturave të brendshme duke përfunduar hetimet për 34 punonjës policie.
- Siç vihet re edhe në vitin e fundit të zbatimit të këtij plani veprimi, Policia e Shtetit ka vazhduar bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë në luftën kundër kriminalitetit. Shkëmbimi i praktikave me organizatat si Interpoli, Europol dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka rritur efektivitetin dhe aftësinë e Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe ka dhënë rezultate konkrete e të matshme për një periudhë afatgjatë.
- Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ka vijuar hetimet administrative mbi ankesat e administruara. Janë përfunduar 23 raporte përfundimtare hetimi administrativ dhe pas analizës së detajuar, janë propozuar 60 masa për fillimin e ecurisë disiplinore, 14 masa për largim nga detyra dhe janë dhënë 80 rekomandime. Gjithashtu, janë konstatuar/dyshuar elementë të veprave penale për disa çështje, konkretisht janë përgatitur 5 kallëzime për ndjekje penale ku janë kallëzuar 16 persona.
- Me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale, AAPSK ka kryer 2 trajnime gjatë kësaj periudhe raportuese kryesisht mbi rikuperimin e asetëve dhe ripërdorimin social dhe punëtoria rajonale mbi konfiskimin dhe ripërdorimin e pasurive kriminale.
- Ministria e Drejtësisë, në Rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, ka zhvilluar disa aktivitete si dhe është hartuar e publikuar buletini mujor i muajit janar, shkurt dhe mars, me një përmbledhjeve të gjithë projekteve, aktiviteteve dhe fushatave publike që ka kryer KKK, i aksesueshëm në linkun <https://drejtesia.gov.al/e-buletin/>.
- Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Shkolla e Magjistraturës lidhën marrëveshje bashkëpunimi për trajnimin e vazhdueshëm të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit, përmes së cilës të dy institucionet do të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre me qëllim formimin vazhdueshëm të koordinatorëve antikorrupsion, për të përmirësuar dhe garantuar aftësitë profesionale të tyre, në shqyrtimin e rasteve të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, si dhe kryerjen e hetimeve administrative brenda fushës së përgjegjësisë publike.

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, së bashku me institucionet e saj të varësisë, ka realizuar një numër të lartë inspektimesh dhe ka referuar masa administrative për subjektet private të konstatuara në shkelje gjatë kësaj periudhe raportuese, gjë e cila e evidenton atë si një nga ministrinë e linjës më aktive në kuadër të politikave të integritetit dhe koordinimit të gjerë institucional si organ i qeverisjes qendrore.

EKZEKUTIMI I BUXHETIT

Sipas SNKK, financimi i Planit të Veprimit realizohet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e partnerëve ndërkombëtarë.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të aktiviteteve e masave të Planit të Veprimit 2020 - 2023, edhe për këtë periudhë institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi buxhetin e përdorur në bazë të performancës së kryer.

Buxheti i përdorur sipas objektivave dhe burimi konkret i financimit është si vijon:

A1: 48.936 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit, sipas parashikimit në Planin e Veprimit.

A2: 87.857 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit, sipas parashikimit në Planin e Veprimit.

A3: 214.400 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit, sipas parashikimit në Planin e Veprimit.

A4: 60.640 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit, sipas parashikimit në Planin e Veprimit.

A5: 19.400 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A6: 43.300 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit, sipas parashikimit në Planin e Veprimit.

A7: 24.136 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit, sipas parashikimit në Planin e Veprimit.

A8: 28.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A9: Nuk raportohen të dhëna për shkak se ky objektivi është realizuar dhe kostuar më herët.

A10: 2.848 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit, sipas parashikimit në Planin e Veprimit.

A11: 38.790 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit, sipas parashikimit në Planin e Veprimit.

B1: 590.541 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit, sipas parashikimit në Planin e Veprimit.

B2: 29.050 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit, sipas parashikimit në Planin e Veprimit.

B3: 37,5 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit, sipas parashikimit në Planin e Veprimit.

B4: 20.995 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit, sipas parashikimit në Planin e Veprimit.

C1: 155.129 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

C2: 0 lekë.

C3: 95.950 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit, sipas parashikimit në Planin e Veprimit.

Edhe për këtë raport monitorimi, rezulton se për një pjesë të aktiviteteve të kryera gjatë këtij viti, zbatimi, kostot vijnë të raportohen në “kosto administrative”, dhe mungon një vlerë konkrete e tyre. Në total, janë 15 aktivitete që raportohen të jenë kryer me “kosto administrative” dhe 85 aktivitete me 0 (zero) kosto/pa raportuar.

Buxheti i përdorur sipas qëllimeve të politikës/Qasjeve A-B-C, është:

Qëllimi i politikës 1 (qasja parandaluese- A)

568.347 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit

Qëllimi i politikës 2 (qasja ndëshkuese - B)

640.623.5 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit.

Qëllimi i politikës 3 (qasja ndërgjegjësuese - C)

251.079 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit

Totali i buxhetit të përdorur për këtë periudhë është:

- *Financimi nga buxheti i shtetit është në shumën 1.460.049,5 lekë.*

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer, rezulton se për periudhën *1 janar - 31 mars 2023*, fushat që kanë treguar performancë por edhe shoqëruar nga problematika janë aktivitete dhe masa të shpërndara në të gjithë objektivet specifike në të tre qëllimet e politikës (qasjet) e SNKK, parandalim (A) – ndëshkim (B) – ndërgjegjësim (C).

Institucionet kanë dëshmuar vazhdimësi, përpjekje dhe vullnet pozitiv për të zbatuar masat, kryer aktivitetet në funksion të tyre, në përputhje me buxhetet e parashikuara në planin e veprimit, mbështetjet e partnerëve ndërkombëtarë dhe vendas; si dhe janë mbështetur në burimet e tyre njerëzore dhe kapacitetet teknike profesionale të brendshme.

Organet publike dhe agjencitë e zbatimit të ligjit po vijnë punën me të dhëna solide, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar si dhe po dëshmojnë një fillim pozitiv në funksion të targetit vjetor që do duhet të arrihet në fund të vitit 2023.

Rekomandime

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet për vijueshmërinë e zbatimit të planit të veprimit janë:

- të fillojë kryerja e aktiviteteve dhe masave për atë objektive të strategjisë, që rezultojnë në nivelin e zbatimit dobët (*nga 0 deri në 30 për qind e masave të zbatuara*), edhe për shkak të mungesës së raportimit, përkatësisht objektivi A.1, A.10, A.11; B.2; B.3; dhe C.3.
- të raportohen kosto për çdo aktivitet që ka filluar dhe përfunduar zbatimin në këtë periudhë raportuese.

- të merren masa nga ministritë e linjës për të monitoruar miratimin dhe zbatimin e Planeve të Integritetit nga të gjitha institucionet e tyre të varësisë.
- të raportohet vlera e aseteve të konfiskuara dhe sekuestruara që ka në administrim AAPSK gjatë kësaj periudhe monitorimi.
- të raportohen të dhëna nga prokuroritë për të mbështetur arritjet në qasjen ndëshkuese të luftës kundër korrupsionit.
- të përmirësohet përfshirja e teknologjisë informative duke shfrytëzuar më tej teknologjinë informative për të forcuar transparencën dhe luftën kundër korrupsionit, duke mbajtur parasysht zhvillimin e mëtejshëm të platformave elektronike për raportimin e rasteve të dyshuara të korrupsionit dhe promovonin e përdorimit të teknologjisë së informacionit për të rritur efikasitetin në zbatimin e planit të veprimit.
- të nxitet përfshirja e shoqërisë civile dhe medias, e të inkurajohet pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile në monitorimin e zbatimit të planit të veprimit. Organizimi i takimeve të rregullta, konsultime publike dhe prezantime të raporteve për të siguruar një ndjeshmëri më të gjerë ndaj çështjeve të korrupsionit dhe të ndërveprimit me institucionet publike.
- të forcohen kapacitetet institucionale dhe të investohet në trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të institucioneve (pikat e kontaktit antikorrupsion) për të menaxhuar dhe zbatuar politikën dhe masat kundër korrupsionit. Të sigurohet gjithashtu që ata të kenë njohuri të mjaftueshme në lidhje me ligjet, rregulloret dhe procedurat e ndjekura në fushën antikorrupsion.
- Të monitorohen dhe vlerësohen rezultatet, duke mbledhur dhe analizuar të dhënat për të matur efektivitetin e masave të ndërmarra dhe identifikuar çështjet që duhet të adresohen më tej. Ky proces duhet të kryhet sidomos nga institucionet qendrore në raport me institucionet e tyre të varësisë. Është e rëndësishme të sigurohet që të gjitha agjencitë dhe institucionet relevante të punojnë së bashku dhe të ndërveprojnë për të arritur qëllimet e planit të veprimit. Në vijim do duhet të kushtohet një vëmendje me e madhe drejt përmirësimit dhe koordinimit mes tyre dhe që të ketë një shkëmbim të rregullt të informacionit dhe bashkëpunimit.

Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit

Rezulton se ndër objektivet me mungesë të plotë realizueshmërie për periudhën raportuese (edhe për arsye të mungesës së raportimit), *janar - mars 2023*, është objektivi C.3. Në këtë raport ka gjithashtu një mungesë informacioni për buxhetin e një sërë masave dhe aktiviteteve si dhe mungon një vlerësim i nevojave konkrete, për fushat që kanë riskun më të lartë.

Një sfidë e rëndësishme është zbatimi efektiv i ligjit, duke siguruar kontroll dhe monitorim të vazhdueshëm, të plotë dhe të gjithanshëm për institucionet dhe agjencitë qendrore apo vendore, duke rritur besimin e publikut dhe përpjekjet për luftën kundër korrupsionit.

Mungesa e shqyrtimit të rasteve të dyshuara të korrupsionit apo praktikave abusive, të publikuara apo raportuara, në disa raste, mund të jetë për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme, mungesës së bashkëpunimit apo ngadalësimit të proceseve dhe vështirësive në sigurimin e provave. Për këtë shkak nevojitet një rikualifikim i nevojave institucionale dhe investime të dedikuara në infrastrukturë.

Boshllëk në mbikëqyrjen financiare: Kontrolli financiar dhe mbikëqyrja e financave publike janë thelbësore për parandalimin e korrupsionit. Megjithatë, në disa raste, ka boshllëqe në sistemin e mbikëqyrjes financiare, duke e bërë më të lehtë për zyrtarët të kryejnë veprime të parregullta apo të paligjshme me paratë publike.

Është e rëndësishme të adresohen këto sfida dhe boshllëqe për të forcuar luftën kundër korrupsionit. Rekomandimet e mësipërme dhe angazhimi i vazhdueshëm i institucioneve për të përmirësuar zbatimin e masave antikorrupsion mund të ndihmojnë në adresimin e këtyre sfidave dhe në përmirësimin e efikasitetit në luftën kundër korrupsionit.

Vlerësimi i riskut duke përdorur masat dhe aktivitetet

Në këtë raport monitorimi, *janar - mars 2023*, ndër risqet që u evidentuan kryesisht, janë të lidhura me kapacitetet teknike, institucionale, proceset e punës, asistencë teknike, bashkëpunimi institucional dhe mjedisi rregullator.

Objektivët të cilat paraqesin një nivel të lartë rrisht janë objektivat A11, B.2, B.3, B.4 dhe C3.

Institucionet përgjegjëse duhet të raportojnë të dhëna në funksion të analizës së objektivit A.1.

Objektivi A11 ka një nivel të lartë rrisht sa i takon përgatitjes së Planeve Vendore të Integritetit dhe përcaktimit të një buxheti specifik për implementimin e tyre, pasi mosmiratimi i tyre në kohë, rrezikon, ndër të tjera, arrijen e indikatorit të mbështetjes buxhetore, edhe në funksion të projekteve IPA.

Objektivët B.2 dhe B.3 kanë një nivel të lartë rrisht për shkak të nevojës së koordinimit të punës mes organeve ligjzbatuese në miratimin, ngritjen dhe vënien në funksion të ZRA dhe adresimit të mbivendosjeve dhe/ose boshllëqeve në mandatet institucionale, hetimet e dyfishta ose të njëkohshme, etj.

Objektivi B.4 paraqet gjithashtu një nivel të lartë rrisht për shkak se elementët e tij përbërës si psh. nënshkrimi i marrëveshjeve të reja, rritja e aksesit të mëtejshëm në bazat e të dhënave, forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional apo hartimi i procedurave standarde dhe mekanizmave të bashkëpunimit janë parakushte të një *trak record-i* solid të organeve të zbatimit të ligjit në qasjen ndëshkuese.

Në kuadër të qasjes ndërgjegjësuere, objektivi C.3 paraqet një rëndësi të madhe dhe një risk të shtuar edhe për shkak të faktit se rezultoni me një realizueshmëri të dobët në mënyrë të përsëritur në periudha të ndryshme të raporteve të monitorimit.

Në përfundim, të gjitha institucionet zbatuese të këtij plani veprimi, duhet të marrin në konsideratë këtë analizë dhe të shtojnë përpjekjet për zbatimin e masave dhe aktiviteteve duke pasur si prioritet arritjen e vlerave të përcaktuara për të arritur qëllimin e objektivëve specifike. Në raportin e ardhshëm të monitorimit, janar - qershor 2023, do të ketë një analizë të shtuar të treguesve të performancës.

Hapat e rradhës

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *janar-mars 2023*, të gjetjeve që ky raport na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, adresohen të ndërmerren këto hapa në vijim:

A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit:

Institucionet publike do duhet të koordinojnë përpjekjet dhe të monitojnë në mënyrë proaktive median e shkruar dhe elektronike për të marrë dijeni dhe trajtuar në kohë ankesat e denoncuar publikisht për krimin e korrupsionit.

A.7: Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut:

Kërkohet rritja e kapaciteteve të auditit të brendshëm, dhe nga ana tjetër të shtohet numri i autoriteteve publike të cilat janë pjesë e vlerësimit të performancës së veprimtarisë audituese.

A.11 Adaptimi i politikave antikorrupsion në nivelin e qeverisjes vendore:

Të vijojë procesi i hartimit të planeve të integritetit në njësitë e qeverisjes vendore duke dedikuar edhe një pjesë të buxhetit për zbatimin e tyre, në mënyrë që të plotësohet objektivi për kushtet e mbështetjes buxhetore.

B2: Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndërshkrimin penal të korrupsionit:

Dhënia teknike e aksesit për 14 përdorues të Prokurorisë së Përgjithshme, në bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit “Për dhënien e të drejtës së aksesit në bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Prokurorisë së Përgjithshme”.

Ngritja e grupeve të përbashkëta të punës dhe hartimi i planeve të punës e planeve të veprimit me fokus hetimin e korrupsionit duhet adresuar me prioritet midis AMP, Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Përgjithshme, SPAK dhe partnerëve ndërkombëtarë si dhe koordinimi i punës mes organeve ligjzbatuese për vënien në funksion të ZRA.

B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit:

Të plotësohet raportimi për këtë objektiv dhe të forcohen kapacitetet e skuadrave të përbashkëta hetimore të ngritura për hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit.

C 1: Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit

Të vijojë realizimi i produkteve në përputhje me çfarë është arritur deri tani, duke mbajtur në vëmendje ato aktivitete që rezultojnë të realizuara pjesërisht/në proces.

C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile:

Të sigurohet efektiviteti i thirrjeve të hapura për propozime specifike në luftën kundër korrupsionit, të financuara nga AMSHC si dhe të merren masat për bashkëpunimin me Policinë e Shtetit për gjenerimin e raporteve vlerësuese.

Aneksi I. Raporti tremujor (janar-mars 2023) i monitorimit për Planin e Veprimit të SNKK, 2015-2023

Kodi	Objektivat Strategjike dhe Institucionet Përgjegjëse Respektive	Periudha e zbatimit të Planit të Veprimit			Kosto indikatorve PV	Buxheti i planifikuar për vitin raportues		Buxheti i përdorur	Progresi deri më tani	Problematikat	Hapatë tjerë	Afati i përfundimit	
		Fundi i vitit	Vlera e Targetit	/OOO total	Totali në %	/OOO total	Totali në %						
								Buxheti i përdorur deri më tani krahasuar me buxhetin indikator (në %)	Jep me % zbatimin për çdo Qëllim Politike dhe Objektiv Specifik	I zbatuar Zbatuar pjesërisht I pazbatuar	text	text	text
1	Buxheti total për strategjinë			Totali 1+2+3	100								

1	Qasja parandaluese	Totali 1					
A.1	A1. Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion						
	KDIMDHP						
	01110 Planifikim, Menaxhim dhe Administrim						
	KDIMDHP						
A.1.1	Krijimi i sistemit të matjes së transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës tek autoritetet publike qendrore dhe të varësisë	16,464				Zbatuar pjesërisht / në proces	2023
A.1.1.1	1 (një) Raport vjetor mbi indeksin e Transparencës së Autoriteteve Publik	Kosto administrative	2058	50%		Zbatuar pjesërisht Raporti vjetor mbi Indeksin e Transparencës së autoriteteve publike do të publikohet në 3M4.	2023
	KDIMDHP						
A.1.1.1.2	Monitorim të transparencës në sasinë e 1/4 të numrit total të autoriteteve publike çdo 3 mujor	4,116 (për çdo vit të PV)	4,116	2058	100%	Zbatuar Është realizuar monitorimi i programeve të transparencës në ¼ e Autoriteteve Qendrore dhe të Varësisë. Në total janë monitoruar 100 nga 313 autoritete publike. Ky aktivitet është realizuar	2023

plotësisht përgjatë kësaj periudhe raportuese.

KDIMDHP

A.1.2	Krijimi i sistemit të matjes së transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës tek njësitë e vetqeverisjes vendore	16,464				Zbatuar pjesërisht / në proces	2023
-------	---	--------	--	--	--	---------------------------------------	------

A.1.2. 1	1 (një) Raport vjetor mbi indeksin e Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore	Kosto administrative	2058		50%	Zbatuar pjesërisht Raporti vjetor mbi Indeksin e Transparencës së këtyre autoriteteve publike do të publikohet në 3M4.	2023
-------------	---	----------------------	------	--	-----	--	------

KDIMDHP

A.1.2. 2	Monitorim të transparencës në sasinë e 1/4 të numrit total te autoriteteve publike çdo 3 mujor	4,116 (për çdo vit të PV)	4,116	2058		100%	Zbatuar Ky monitorim është realizuar në ¼ e numrit total të autoriteteve publike/ njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në total janë monitoruar 16 nga 61 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore.	2023
-------------	--	----------------------------	-------	------	--	------	---	------

KDIMDHP

A.1.3	Instalimi i regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve dhe mbikëqyrja e përditësimit të regjistrit nga ana e koordinatorëve për të drejtën e informimit (2020-21 institucione; 2021-24 institucione; 2022-25 institucione; 2023-25 institucione).	16,008				Zbatuar	2023
-------	--	--------	--	--	--	----------------	------

A.1.3. 1	Numri i institucioneve ku është instaluar regjistri qendror i kërkesave dhe përgjigjeve	4,092; (për çdo vitzbatim i të PV)	2001	100%	Zbatuar Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve është instaluar për 3M1 në 27 autoritete publike, duke e çuar numrin total të autoriteteve publike që kanë instaluar regjistrin elektronik në 222 autoritete.	2023
KDIMDHP						
Institucion kontribues: Autoritete publike						
A.1.3. 2	Monitorime të KDIMDHP ndaj koordinatoreve të AP për regjistrin e kërkesë/ankesave	Kosto administrative	2001	100%	Zbatuar Është kryer monitorimi i autoriteteve publike për regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve.	2023
KDIMDHP						
Institucion kontribues: Autoritete publike						
A.2	A2. Rritja e transparencës në planifikimin, detajimin, menaxhimin dhe kontrollin e fondeve buxhetore					
APP						
1087001, Shërbimi i Prokurimit Publik						
APP						
A.2.1	Përmirësimi i procesit të planifikimit nëpërmjet publikimit paraprak të procedurave të prokurimit	8,919			Zbatuar	2023

A.2.1. 1	Hartimi dhe miratimi i formularëve të njoftimit paraprak dhe njoftimit periodik të procedurave të prokurimit	Kosto administrative	100%	Zbatuar	2023
APP					
A.2.1. 2	Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me përdorimin e njoftimeve paraprake dhe periodike të procedurave të prokurimit (trajnime, vizita studimore, etj)	8,919	100%	Zbatuar	2023
Stafi aktual është trajnuar plotësisht, dhe për këtë arsye ky aktivitet konsiderohet i realizuar plotësisht.					
Në faqen zyrtare të saj, APP ka publikuar një udhërrëfyes orientues për të gjitha Autoritetet Kontraktore në lidhje me “Zbatimin e prokurimit publik të gjelbër në Shqipëri” konkretisht në: https://www.app.gov.al/GetD ata/DownloadDoc?documentId=92c25399-7384-45d8-8358-613148b7165c					
Vendimi nr. 22 datë 18.01.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 384, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik” është publikuar në: https://www.app.gov.al/GetD ata/DownloadDoc?documentId=95876131-18ab-4ecb-8cdf-40a17f461152 si dhe ndryshimet e përcaktuara në këtë vendim.					

APP					
A.2.2	Mekanizma për përmirësimin e zbatimit të kontratave	32,811		Zbatuar	2023
A.2.2.1	Hartimi dhe miratimi i instrumentave të nevojshëm për monitorimin e zbatimit të kontratës (Plani i zbatimit të kontratës; formulari i zbatimit të kontratës)	Kosto administrative	100%	Zbatuar Është hartuar plani i monitorimit, me objekt hartimin dhe dërgimin nga autoritetet kontraktore të raportit për zbatimin e kontratës.	2023
APP					
A.2.2.2	Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me monitorimin e zbatimit të kontratës (trajnime, vizita studimore, etj).	32,811	100%	Zbatuar Janë kryer trajnimet përkatëse për forcimin e kapaciteteve të punonjësve të APP.	2023
APP					
A.2.3	Mekanizma për përmirësimin e dokumentave të tenderit dhe specifikimeve teknike	46,127		Zbatuar	2023
A.2.3.1	Hartimi dhe publikimi i rekomandimeve të vazhdueshme nga APP në lidhje me përmbajtjen e dokumentave të tenderit të përgatitura nga autoritetet/entet kontraktore me qëllim përmirësimin e tyre (Nr. i rekomandimeve të nxjerra)	Kosto administrative	100%	Zbatuar Në muajin dhjetor, APP zhvilloi një tryezë diskutimi dypalëshe me Autoritetin e Konkurrencës të cilat kanë konkluduar në firmosje e përbashkët të një Udhërrëfyesi “Prokurimi Publik dhe Mbrojtja e Konkurrencës, Integriteti i Procesit të Prokurimeve Publike” nga dy institucionet.	2023

Ky udhërrëfyes synon mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në prokurimet publike, me fokus parandalimin e marrëveshjeve të fshehta në prokurimet publike. Në këtë takim përveç përfaqësuesve të Autoritetit të Konkurrencës dhe të Agjencisë së Prokurimit Publik morën pjesë edhe përfaqësues të komunitetit të biznesit, dhomave të tregtisë dhe industrisë, studiove ligjore, etj.

<https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=ac0e1d51-4fdf-4718-bba6-bd2e3c45c9e0>

APP

46,127

100%

Zbatuar

2023

Përfaqësues të APP përgjatë muajit mars 2023 kanë zhvilluar 4 (katër) takime informues nderinstitucionale.

Takimet janë zhvilluar me institucione si poshte vijon:

DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit)

ISHTI (Inspektiati Shtetëror Teknik dhe Industrial)

DPS (Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit)

A.2.3.2 Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me përgatitjen e dokumentave të tenderit, në përputhje me parimet e transparencës, mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë, konkurrencës së lirë dhe të ndershme (trajnime, vizita studimore, etj)

				Drejtoria e licencave në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë	
				Takimet kanë synuar rakordimin e punës për nxjerrjen e rekomandimeve të përgjithshme, për të ndihmuar autoritetet kontraktore në rritjen e performancës dhe eficiencës gjatë hartimit të procedurave të prokurimit publik.	
	APP				
A.3	A. 3: Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike				
	AKSHI				
	01140, e-Qeverisja				
	AKSHI				
A.3.1	Numri i shërbimeve elektronike funksionale për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike	214,400		Zbatuar	2023
		kosto administrative	100%	Zbatuar	2023
A.3.1.1	Nr. shërbimesh elektronike të shtuara; (2020-602 shërbime; 2021-670 shërbime; 2022-720 shërbime e 2023-750 shërbime)			Për vitin 2022, AKSHI ka vijuar punën për shtimin e shërbimeve elektronike dhe përmirësimin e shërbimeve ekzistuese në portalin unik qeveritar e-Albania. Ndërkohë është rritur edhe numri i sistemeve të lidhura me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit. Në portalin e-	

Albania ofrohen në total 1227 shërbime elektronike deri në fund të marsit 2023.

AKSHI

A.3.1. 2	Përcaktim i formës së aplikimit për e-shërbimet; kryerje analize e regjistrave elektronike ndërveprues	kosto administrative	100%	Zbatuar Kjo forme përcaktohet për çdo e-shërbim së bashku me analizen përkatëse.	2023
-------------	--	----------------------	------	--	------

AKSHI

A.3.1. 3	Kryerje e zhvillimeve teknike për ekspozimin e të dhënave nga e-sistemet fundore të institucioneve	107,200	100%	Zbatuar Çdo ekspozim të dhënash në e-sistemet fundore është realizuar përmes zhvillimeve teknike.	2023
-------------	--	---------	------	---	------

AKSHI

A.3.1. 4	Kryerje e zhvillimeve teknike për të konsumuar webservice-t përkatëse të e-sistemeve	107,200	100%	Zbatuar Për çdo webservice të nevojshëm është kryer zhvillimi përkatës teknik.	2023
-------------	--	---------	------	--	------

AKSHI

A.3.1. 5	Kryerja e vlerësimit për strukturimin e informacionit për publikim në portalin e-Albania	kosto administrative	100%	Zbatuar Cdo informacion që shfaqet në publikim është strukturuar dhe vlerësuar paraprakisht.	2023
-------------	--	----------------------	------	--	------

AKSHI

A.3.1. 6	Zhvillimet e nevojshme teknike për implementimin e shërbimit me vulë elektronike/nënshkrim elektronik (që mund të ofrohet).	kosto administrative	100%	Zbatuar Ky shërbim tashmë pas zhvillimeve të veta, është plotësisht funksional.	2023
AKSHI					
A.4	A. 4: Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit				
PSH, SHÇBA					
01110 Planifikim Menaxhim (SHÇBA); 3140 "Policia e Shtetit"					
PSH, SHÇBA					
A. 4.2	Ndërveprim funksional dhe përmirësim bashkëpunimi të strukturave të Policisë së Shtetit që hetojnë korrupsionin, në portalin www.shqiperiaqeduam.al	0		Zbatuar pjesërisht / në proces	2023
		0	0%	Pazbatuar	2023
A.4.2. 1	Marrëveshje bashkëpunimi PSH-ADB			Nuk ka patur zhvillime të reja në kuadër të nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi mes PSH dhe ADB.	
PSH					
Institucion kontribues: ADB					
A.4.2. 2	Nr. i rasteve të aksesit të PSh në platformë;	0	100%	Zbatuar Nga strukturat e Policisë në adresën e Platformës së Bashkëqeverisjes për	2023

tremujorin e parë janë marrë gjithsejt 143 ankesa. Ankesat në platformën e bashkëqeverisjes janë kryesisht për:

-Konflikt pronësie e mos mbështetje nga strukturat e policisë.

-Ankesë për punonjësit e strukturave e policisë për probleme të ndryshme.

-Për vendosje gjobe në mënyrë të padrejtë, etj.

Për cdo ankesë të marrë, janë sqaruar ose drejtuar për sqarim në strukturat vendore ose institucione të tjera që kanë kompetencë problemet e trajtuara prej tyre.

-Për 4 nga ankesat për dyshime të arsyeshme për vepra penale janë dërguar për trajtim në Drejtorite vendore të policive përkatëse dhe është sugjeruar fillimi i procedimit penal nëse ekzistojnë elemente të veprave penale.

PSH

Institucion kontribues: ADB

A.4.3 Forcim bashkëpunimi PSH- SHÇBA për hetimin e subjekteve të përfshira në korrupsion

0

Zbatuar pjesërisht / në proces

2023

A.4.3. 1	Ngritja e grupeve të përbashkëta institucionale të punës PSh - SHÇBA; Nr. i rasteve të hetimeve të përbashkëta	0	0%	Pazbatuar	2023
Nuk ka zhvillime të reja për këtë periudhë raportuese.					
PSH, SHÇBA					
A.4.3. 2	Nr. i subjekteve të dërguara për procedime penale për veprën penale të korrupsionit nga hetimet përbashkëta.	0	100%	Zbatuar	2023
Gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2023, janë evidentuar:					
-185 Vepra Penale,					
-146 zbuluar, ose 78.9%, me:					
-200 autore të dyshuar;					
- 38 autore arrestuar/ndaluar					
- 158 autore proceduar në gjendje të lire.					
- 4 autore shpallur në kerkim.					
- Vetëm për veprat penale të korrupsionit, janë evidentuar:					
- 89 vepra penale. Janë zbuluar 73 zbuluar prej tyre me:					
-87 autorë të dyshuar,					
-15 autorë arrestuar/ndaluar,					
-70 autorë proceduar në gjendje të lire.					
-2 autorë janë shpallur në kerkim.					
Gjatë tremujorit nga denoncimet e qytetarëve janë evidentuar gjithësej 17 kallëzime për vepra penale për korrupsionin e krime në					

detyrë, me 16 autorë të cilët ndiqen në gjendje të lirë.

PSH, SHÇBA

A.4.4	Kapacitete të ngritura të strukturave të specializuara që merren me hetimin e krimit të korrupsionit në PSH	17,500		Zbatuar pjesërisht / në proces	2023
A.4.4.1	Trajnime të kryera (shefa të sektorëve në DVP dhe specialistëve kundër korrupsionit në DPP)	17,500	100%	Zbatuar	2023
				Gjatë kësaj periudhe raportuese, janë kryer 5 trajnime me 47 përfitues në total, nga të cilët 19 janë femra:	
				1-Mbi hetimin e avancuar të krimit financiar organizuar nga IPA EU4FOCAL ne Hotel Internacional Tirana, me 10 përfitues nga te cilet 4 femra.	
				2-Mbi Pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve, organizuar nga IPA EU4FOCAL ne Hotel Internacional Tirana, me 4 prftitues nga te cilet 3 Femera.	
				3- Mbi Pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve organizuar nga IPA EU4FOCAL Hotel Coloseu	

Shkoder me 4 përfitues nga te cilet 3 Femera.

4-Mbi hetimin e veprave penale të Kondrabandës, evazionit fiskal, mashtrimit në kredi dhe përcaktimi i rezultateve në garat sportive, organizuar nga Akademia e Sigurise me 23 prftitues nga të cilet 9 Femera.

5-Për monedhën virtuale dhe format e reja të krimit të kryera përmes internetit, organizuar nga eksperte të EU4FOCAL, në Hotel Internacional Tirana, me 5 përfitues, të gjithë meshkuj.

PSH

A.4.4. Nr. i personave të trajnuar, 20 persona/vit
2

kosto
administr
ative

100%

Zbatuar

2023

Gjatë kësaj periudhe raportuese, janë kryer 5 trajnime me 47 persona të trajnuar në total, nga të cilët 19 janë femra. Trajnimet janë:

1-Mbi hetimin e avancuar të krimit financiar organizuar nga IPA EU4FOCAL ne Hotel Internacional Tirana, me 10 përfitues nga te cilet 4 femra.

2-Mbi Pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve, organizuar nga IPA EU4FOCAL ne Hotel Internacional Tirana, me 4 prftitues nga te cilet 3 Femera.

3- Mbi Pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve organizuar nga IPA EU4FOCAL Hotel Coloseu Shkoder me 4 përfitues nga te cilet 3 Femera.

4-Mbi hetimin e veprave penale të Kondrabandës, evazionit fiskal, mashtrimit në kredi dhe përcaktimi i rezultateve në garat sportive, organizuar nga Akademia e Sigurise me 23 prftitues nga të cilet 9 Femera.

5-Për monedhën virtuale dhe format e reja të kimit të kryera përmes internetit, organizuar nga eksperte të EU4FOCAL, në Hotel Internacional Tirana, me 5 përfitues, të gjithë meshkuj.

PSH

A.4.4. 3	Trajnime të specialistëve për hetimin e korrupsionit, pranë ambienteve të Qendrës së Formimit Policorë Tiranë, me trajnues nga strukturat e Prokurorisë dhe Gjykatës, 126 persona/vit. (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).	kosto administrative	0%	Pazbatuar	2023
				Nuk ka patur zhvillime të reja gjatë kësaj periudhe raportuese.	

PSH							
A.4.5	Monitorim proaktiv dhe i vazhdueshëm i medias së shkruar dhe elektronike, rrjeteve sociale, pritja dhe zgjidhja në kohë ankesave/rasteve/informacioneve të denoncuar publikisht për krimin e korrupsionit	43,140				Zbatuar	2023
A.4.5. 1	Forcimi i kapaciteteve të strukturave teknike të PSH dhe SHÇBA për monitorimin/gjurminin e rasteve	43,140	10,785	100%		Zbatuar	2023
						<p>Gjatë kësaj periudhe raportuese, janë kryer këto trajnime:</p> <p>1-Mbi hetimin e avancuar të krimit financiar organizuar nga IPA EU4FOCAL ne Hotel Internacional Tirana, me 10 përfitues nga te cilet 4 femra.</p> <p>2-Mbi Pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve, organizuar nga IPA EU4FOCAL ne Hotel Internacional Tirana, me 4 prftitues nga te cilet 3 Femera.</p> <p>3- Mbi Pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve organizuar nga IPA EU4FOCAL Hotel Coloseu Shkoder me 4 përfitues nga te cilet 3 Femera.</p> <p>4-Mbi hetimin e veprave penale të Kondrabandës, evazionit fiskal, mashtrimit në kredi dhe përcaktimi i rezultateve në garat sportive,</p>	

organizuar nga Akademia e Sigurise me 23 prftitues nga të cilet 9 Femera.

5-Për monedhën virtuale dhe format e reja të kimit të kryera përmes internetit, organizuar nga eksperte të EU4FOCAL, në Hotel Internacional Tirana, me 5 përfitues, të gjithë meshkuj.

AMP ka ngritur Sistemin e Menaxhimit te Çeshtjes/Moduli i Ankesave, per administrimin dhe ndjekjen e trajtimin e ankesave te qytetareve.

Agjencia pranë linjës së gjelbër ka marrë 880 telefonata, ku:

□ 416 telefonata kanë qenë brenda objektit të punës së AMP-së dhe nëpërmjet strukturave të Agjencisë është kontaktuar menjëherë telefonuesi duke i dhënë zgjidhje problemit të ngritur.

□ 165 telefonata kanë qenë jashtë fushës së veprimtarisë së AMP-së dhe shtetasve u është dhënë informacioni i kërkuar dhe janë adresuar pranë strukturës përkatëse ku duhet të depozitohen ankesën e tyre.

□ 299 telefonata kanë qenë me objekt informacion në lidhje me veprimtarinë e AMP-së.

Janë administruar në sistemin e Menaxhimit të Çështjeve/Moduli i Ankesave, 233 ankesa të ardhura pranë Shërbimit, nga të gjitha portat e komunikimit të vëna në dispozicion të tyre, ku:

Nëpërmjet e-mail-it të AMP-së 133 ankesa;

Nëpërmjet postës zyrtarë të AMP-së 45 ankesa;

Nëpërmjet paraqitjes në zyrat e ankesave 32 ankesa;

Nëpërmjet linjës së gjelbër 7 ankesa;

Nëpërmjet paraqitjes në zyrën e ankesave të AMP-së 6 ankesa;

Nëpërmjet institucioneve të tjera 3 ankesa;

Nga Avokati i Popullit 3 ankesa;

Nga Portali i Bashkëqeverisjes 3 ankesa;

Nga publike në media e rrjete sociale 1 ankesë.

Në përfundim të hetimeve:

Në 13 raste është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, në Policinë e Shtetit dhe Komisioni Disiplinor i Agjencisë, për 34 punonjës policie, të ndara sipas shërbimeve të policisë:

Në 6 raste për 15 punonjës të strukturave të hetimit të krimit

Në 3 raste për 13 punonjës të strukturave të rendit dhe sigurisë publike

Në 2 raste për 3 punonjës të strukturave të kufirit & migracionit

Në 2 raste për 3 punonjës të strukturave të policisë rrugore

PSH, SHÇBA

Nr. i personave/staf i përfshirë në këto grupe për monitorimin e rasteve të denoncuara për prirje për korrupsion

kosto
administrative

100%

Zbatuar

2023

A.4.5.
2

Gjatë kësaj periudhe raportuese, janë kryer 5 trajnime me 47 përfitues në total, nga të cilët 19 janë femra.

Agjencia, ka Drejtorine e Inspektimit dhe Ankesave,

me 3 sektore, 2 prej tyre
Sektori i Ankesave dhe
Sektori i Pritjes se Qytetareve
(linja e gjelber 0800 90 90).

PSH, SHÇBA

A.5 A. 5: Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave

ILDKPKI

01110 Planifikim Menaxhim

ILDKPKI

A.5.2	Mirëmbajtja e sistemit elektronik të deklarimit të pasurive dhe interesave private	80,000					Zbatuar			2023
A.5.2.1	Sistemi elektronik në gjendje funksionale (mirëmbajtje për çdo vit)	80,000	19,400	24.25%	56.58%	100%	Zbatuar Për periudhën raportuese tremujori i parë i vitit 2023, ky aktivitet është plotësisht i realizuar, pasi sistemi elektronik është në gjendje funksionale dhe mirëmbahet çdo vit.	Vazhdimi i zbatimit të kontratës "Shërbimi i Mirëmbajtjes së Sistemit të Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të	Sipas parashtimit të kontratës përkatëse "Shërbimi i Mirëmbajtjes së Sistemit të Deklarimit të Pasurisë	2023

					Interesit dhe Konfliktet e Interesit EACI DS” sistemi elektronik në gjendje funksionale (mirëmbajtje për çdo vit)
	ILDKPKI				
A 6	A 6: Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike				
	KQZ				
	1073001, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve				
	KQZ				
A. 6.1	Përmirësim (rishikim i mëtejshëm) i modelit standard për raportimin financiar për vitin kalendarik; Forcimi i kapaciteteve për financierët e partive, strukturën e posaçme në KQZ, audituesit ligjorë.	6,540		Zbatuar	2023
A. 6.1.1	Modeli standard i miratuar/i rishikuar (në përputhje me ndryshimet e reformës legjislativë)	kosto administrative	100%	Zbatuar Kërkohet evidenca e zbatimit	2023

KQZ

A. 6.1.2	Seanca trajnimi të kryera (I) Seanca trajnimi të kryera për modelin e raportimit financiar (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).	6,540	100%	Zbatuar Është kryer një seancë trajnimi me financierët e partive politike lidhur me formatin e standardizuar për raportimin vjetor.	KQZ me mbështetje në KiE ka implimentuar Platformën Elektronike për Raportimin Financiar nëpërmjet të cilës financierët e partive politike do kryejnë raportimet financiare të partive politike	2023
-------------	---	-------	------	---	---	------

ke.
Është
në
proce
s për
t'u
bërë
trajni
mi i
financ
ierëve
lidhur
me
raport
imin
ne
platfo
rmë.

KQZ

A. 6.2	Ngritja e kapaciteteve profesionale për personat përgjegjës që kontrollojnë financimin e partive politike; Forcim i kapaciteteve për stafin teknik të KQZ	9,190		Zbatuar	2023
A. 6.2.1	Trajnime të kryera (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj)	9,190	100%	Zbatuar Janë kryer trajnime për personat përgjegjës të cilët lidhen drejtpërdrejtë me përdorimin e Platformës Eelektronike për raportimin financiar	2023

KQZ

A.6.2. 2	Tryeza pune/seminare për stafin e KQZ.	kosto administr ative	100%	Zbatuar	2023
-------------	--	-----------------------------	------	----------------	------

Janë zhvilluar tryeza pune me ekspertë të fushës për të forcuar kapacitetet e stafit teknik.

A.6.3	Përmirësim (rishikim i mëtejshëm) i formatit standard për raportimin nga ekspertët monitorues dhe audituesit ligjorë për përdorimin e raporteve të miratuara; Forcim/zhvillim i kapaciteteve për stafin teknik të KQZ, për përdorimin e raporteve të miratuara	9,190		Zbatuar	2023
A.6.3.1	Modeli standard i miratuar/i rishikuar	kosto administrative	100%	Zbatuar Kërkohej evidenca e zbatimit	2023
	KQZ				
A.6.3.2	Trajnime të kryera për përvetësimin dhe plotësimin në mënyrën e duhur të këtij formati (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).	9,190	100%	Zbatuar Kërkohej evidenca e zbatimit	2023
	KQZ				
A.6.4	Përditësim i vazhdueshëm i udhëzimeve në lidhje me raportimin financiar (në përputhje me ndryshimet mundshme ligjore); Forcim i kapaciteteve për stafin teknik të KQZ, për përdorimin e raporteve të miratuara	9,190		Zbatuar	2023
A.6.4.1	Udhëzimet e përditësuara të raportimit financiar	kosto administrative	100%	Zbatuar Kërkohej evidenca e zbatimit	2023
	KQZ				
A.6.4.2	Trajnime të kryera për përvetësimin dhe plotësimin në mënyrën e duhur të këtij formati.	9,190	100%	Zbatuar Kërkohej evidenca e zbatimit	2023

KQZ						
A.6.5	Përditësim i vazhdueshëm i metodologjisë së kontrollit dhe verifikimit të financave të partive politike; Forcimi i kapaciteteve për strukturën e posaçme në KQZ, dhe gjithë palët e interesuara në lidhje me këtë metodologji (seanca trajnimesh të programuara)	9,190			Zbatuar pjesërisht / në proces	2023
A.6.5.1	Metodologji e përmirësuar/ e përditësuar	kosto administrative	50%	Zbatuar pjesërisht Kërkohet evidenca	Mungesa e informacionit në lidhje me praktikatat e vendeve më të zhvilluara.	Bashkëpunimi me faktorët ndërkombëtarë Tryeza pune me ekspertët ndërkombëtarë
KQZ						
A.6.5.2	Nr.personash të trajnuar (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj)	9,190	100%	Zbatuar Kërkohet evidenca e zbatimit		2023
KQZ						
A.6.5.3	Raportet kontrolli të financave të partive politike të publikuar/ raporte të KQZ të publikuar.	kosto administrative	100%	Zbatuar Kërkohet evidenca e zbatimit		2023

KQZ				
A.7	A 7: Përmiresimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut			
MFE				
01120 "Menaxhimi i Shpenzimeve Publike"				
MFE				
A. 7.1	Rritja e kapaciteteve të auditit të brendshëm përmes zhvillimit të trajnimeve të vijueshme profesionale (TVP) të organizuara çdo vit, ku përfshihen çështje të mashtrimit dhe korrupsionit dhe kryerja e vlerësimeve të jashtme të cilësisë (VJC), të cilat fokusohen tek vlerësimi i performances së veprimtarisë audituese dhe tek rekomandimet e dhëna për përmirësimet e nevojshme në aktivitetin e auditit të brendshëm	23,570	Zbatuar pjesërisht/në proces	2023
A.7.1.1	Vlerësimi i nevojave për trajnim (I) Hartimi dhe miratimi i programit të TVP (II) Përgatitja e materialeve të trajnimit (III) Zbatimi i programit të TVP dhe 100% e auditit të brendshëm të punësuar dhe të certifikuar në sektorin publik (IV) 15 vlerësime të jashtme të cilësisë/vit.	34%	100% Zbatuar	2023
			Është miratuar programi vjetor i TVP për vitin 2023 urdhër të MFE nr.295, date 30.12.22. Zbatimi i TVP fillon ne Prill 2023. Në këtë program janë parashikuar të trajnohen 350 auditues te brendshem.	
			Është kryer miratimi i planit vjetor te Drejtorise se harmonizimit te Auditimit te Brendshem (perfshire Vleresimin e Jashtem te Cilesise), me shkr.	

nr.4806/1, date 09.03.2023.
Zbatimi i Planit fillon në prill
2023 dhe është parashikuar
vleresimi i 20 NJAB.

MFE

50% **Zbatuar pjesërisht** 2023

A.7.1. Kryerja e auditimeve të brendshme pilot dhe
4 vizitë studimore mbi etikën dhe integritetin.

Kryerja e auditimeve të
brendshme pilot, vijon të
mbetet në proces, pasi
DH/AB qëndron në pritje të
suportit nga asistenca teknike.

MFE

A. 7. 3 Rritja e kapaciteteve të inspektimit financiar
publik përmes zhvillimit të trajnimeve
profesionale vazhduese të organizuara çdo vit,
në të cilat përfshihen çështje të mashtrimit dhe
korrupsionit

269

**Zbatuar pjesërisht/në
proces**

2023

A.7.3.
1

269

269

100%

Zbatuar

2023

Vlerësimi i nevojave për trajnim (I) Hartimi i
programit të trajnimit (II) Trajnimi i
inspektorëve financiarë publikë, lidhur me
trajtimin e parregullsisve financiare,
keqmenaxhimin financiar, shpërdorimit të
detyrës dhe korrupsionit (sa të trajnuar femra
dhe sa meshkuj) (III)

Gjatë kësaj periudhe
raportimi janë trajnuar 7
inspektorë financiarë publik
mbi menaxhimin e riskut,
trajnimin i kryer në datën 10
Shkurt 2023; si dhe 8
inspektorë mbi kontrollin e
brendshëm financiar publik,
statusin dhe zhvillimet në këtë
fushë, trajnimin i kryer në datën
10 Mars 2023.

MFE

A.7.3. 2	Trajnime të strukturës së Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale për hetimin e korrupsionit, pranë ambienteve të Qendrës së Formimit Policor Tiranë, me trajnues nga strukturat e Policisë, Prokurorisë, Gjykatës, etj.	kosto administrative	0%	Pazbatuar Mungon raportimi	2023
*Trajnimet kryhen për çdo vit të zbatimit të PV					
MFE					
A.7.3. 3	Kryerja e vizitave studimore dhe seminareve mbi etikën dhe integritetin	kosto administrative	0%	Pazbatuar Mungon raportimi	2023
MFE					
A.7.3. 4	Përfaqësuesit e strukturës Antikorrupsion të informohen mbi mundësitë e bashkëpunimit me strukturat e tjera ndërinstitucionale, dhe të zhvillojnë seminare të përbashkëta lidhur me detyrat e tyre funksionale (DPD, DPT, PSH, etj.)	kosto administrative	0%	Pazbatuar Mungon raportimi	2023
MFE					
A. 7.4	Veprimtari informuese/sensibilizuese, me qëllim ndërgjegjësimin e institucioneve publike dhe publikut mbi funksionet e DIFP si dhe rritjen e transparencës mbi misionin e inspektimit	297		Zbatuar	2023
		297	100%	Zbatuar	2023
A.7.4. 1	Informacion i përditësuar në faqen zyrtare mbi DIFP (I) Deklarata të bëra publike (II) Menu informacioni në web (III)			Është përditësuar informacioni mbi veprimtarinë e DIFP në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.	

	MFE				
A.8	A 8: Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion				
	MD, Ministrinë, TFA, të gjitha institucionet				
	01110 Planifikim Menaxhim Administrim, Ministria e Drejtësisë/Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme/ Ministria e Mbrojtjes/ Ministria e Brendshme/ Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë/Ministria e Kulturës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit				
	MD, Ministrinë, TFA, të gjitha institucionet				
A.8.4	Vlerësimi i riskut të integritetit në institucionet qendrore dhe varësitë e tyre, sipas Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për qeverisjen qendrore (udhëzuesi)	1,170		Zbatuar pjesërisht/ në proces	2023
		Kosto administrative	50%	Zbatuar pjesërisht	MTM 2023
A.8.4.3	Vlerësimi i riskut nga ministrinë dhe institucionet e tyre të varësisë, i hartuar dhe i miratuar			Është hartuar dhe miratuar vlerësimi i riskut nga ministrinë dhe institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë. Planet e Integritetit, të miratuara janë bazuar në rezultatet e vlerësimit të riskut në proceset kryesore të punës në institucionet publike.	po punon per ngritjen e nje platfome online të dedikuar për statist

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

ka rritur transparencën me numrin e publikimeve të dokumentave që kanë të bëjnë me buxhetin projektet si dhe aktivitetet të tjera që ndërmerr Ministria. Është përmirësuar procesin e auditimit të brendshëm (rritja e numrit të kontrolleve dhe cilesinë e kontrollit). Gjithashtu pothuajse të gjitha shërbimet që ofron MTM ofrohen nëpërmjet platformës e-albania.

MB ka kryer identifikimin e risqeve për të gjitha proceset dhe fusha të ndryshme si dhe për të gjitha nivelet, përfshirë edhe këshilltarët politikë, të vlerësuar si potencialisht të riskuara apo të ekspozuara në drejtim të çënimit të integritetit të punonjësve dhe të institucionit. Risqet e identifikuar u konceptuan dhe kategorizuan në disa grupe e fusha të mëdha risku: në fushën e prokurimit publik; në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore; në fushën e menaxhimit financiar, të projekteve, aseteve dhe shërbimeve mbështetëse; në

ikat e turizmit dhe mjedisit.

fushën e arkivimit, ruajtjes së informacionit dhe administrimit të dokumentacionit; në fushën e inspektimeve/kontrolleve dhe lëshimit të licensave e certifikimeve; në fushën e shërbimeve të drejtpërdrejta për qytetarët apo shërbimeve të tjera si dhe risqe të lidhura me shkeljen e etikës, paanshmërisë, cënimin e dinjitetit, reputacionit dhe imazhit të institucionit.

Në fund të procesit të analizës së fushave dhe proceseve të riskuara, u bë integrimi i tyre në një dokument komprehensiv “Matrica e Riskut të Integritetit në aparatit, institucionet dhe strukturat e Ministrisë së Brendshme”. Ky dokument themelor shërbeu si baza kryesore për konceptimin dhe organizimin e Planit të Integritetit në institucion dhe për planifikimin e të gjitha masave në këtë drejtim. Mbi këtë bazë, grupi i punës vijoi me hartimin e dokumentit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Brendshme dhe Planit të Veprimit 2022-2024

në zbatim të tij, i cili u miratua me urdhër të Ministrit të Brendshëm.

I njëjti proces u ndoq dhe nga institucionet e varësisë të MB, për hartimin e Planeve të tyre të Integritetit. Institucionet e varësisë së Ministrisë së Brendshme vijuan procesin e hartimit të Planeve të tyre të Integritetit, duke filluar me kryerjen e analizave të riskut nga secili institucion. Ky proces ka përfunduar për këto institucione varësie:

- Policia e Shtetit,
- Agjencia e Mbikeqyrjes Policore,
- Garda e Republikës,
- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit,
- Agjencia për Mbeshtetjen e Vetëqeverisjes Vendore,
- Qendra Pritese për Azilkerkues,
- Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara,

- Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin, si dhe
- Shtepia e Pushimit e Ministrise se Brendshme.

Ministritë e linjës

A. 8.5	Kontrolli dhe verifikimi (hetimi administrativ) i zbatimit të ligjshmërisë dhe/ose denoncimeve për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në të gjitha institucionet e administratës publike dhe agjencitë shtetërore	9,600				Zbatuar	2023
		9,600	28.000	100%		Zbatuar	2023
A.8.5. 1	Nr. i raporteve të inspektimeve të grupeve të inspektimit (I) Nr. i masave të marra në përfundim të inspektimeve (II) Nr. i rasteve të referuara në prokurori (III)					<p>DPA/KKK Gjatë kësaj periudhe janë administruar 16 ankesa. Në përfundim të shqyrtimit të tyre, janë dhënë 2 masa për fillimin e ecurisë disiplinore, 1 masë për largim nga detyra, 13 rekomandime si dhe janë referuar 2 raste në prokurori.</p> <p>Në ATP është: zero(0) numri i raporteve të inspektimeve të grupeve të inspektimit; Zero(0) Nr. i masave të marra në përfundim të inspektimeve (II); Zero(0) Nr. i rasteve të referuara në prokurori (III)</p>	

MBZHR dhe 4 institucionet
vartësisë. Përmbledhje:

Kërkesa 284

Trajtuar 277

Proces 6

Deleguar 1

Gjithashtu janë:

Faqja zyrtare 45

Platforma 17

Të detajuara sipas objekteve
statusi i kërkesave është si më
poshtë:

MBZHR. Në regjistrin e
kërkesave dhe përgjigjeve për
informim publik janë:

-16 regjistruar

- 15 zgjidhur

-1 deleguar autoritetit
kopetent, referuar ligjit nr.
119/2014 “Për të drejtën e
informimit”.

AKU

Janë paraqitur:

Ankesa/kërkesa

248 gjithsej:

-156 raste nga
info@aku.gov.al,

-62 raste nga numri i gjelbër,

-30 raste nga faqet zyrtare.

Nga 156 rastet
info@aku.gov.al:

-153 kthyer përgjigje të
interesarve brenda afateve
kohore.

-3 raste janë ende në proces.

Nga 62 raste të mbërritura nga
numri i gjelbër, është kthyer
përgjigje brenda afatit:

Nga 30 rastet e mësipërme:

-27 raste kthyer përgjigje të
interesarve brenda afateve

-3 raste janë në proces.

□ Në faqet zyrtare,

45 raste të paraqitur, a janë
trajtuar dhe iu është kthyer
përgjigje brenda afateve
kohore.

□ Platforma
bashkëqeverisja

17 raste.

AZHBR.

Në AZHBR kanë ardhur gjithsej

= 20 kërkesa/ankesa, të cilat janë zgjidhur brenda afatit

- 20 zgjidhur

= nuk janë identifikuar raste sinjalizim per praktika abuzive

DSHPA (PESHKIMI)

Nuk janë paraqitur ankesa për punnjësit e institucionit.

AKVMB

Nuk ka informacion për hetime administrative.

Inspektime total **24.602**

Masa gjithsej **1.293,**

nga këto:

=**1**Kallëzuar penalisht

